

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit
Titulli i lëndës:	Gjeografia Turistike
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi - ECTS:	4
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Alberta Tahiri
Detajat kontaktuese:	alberta.tahiri@ushaf.net
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Gjeografia Turistike” ofron një pasqyrë të përgjithshme të njohurive mbi kuptimin dhe zhvillimin e turizmit në këndvështrimin e tij gjeografik, dhe nëpër periudha të ndryshme kohore. Objekt i lëndës janë analizat e dukurive dhe fenomeneve që ndërlidhen me zhvillimin e turizmit dhe ndikimet që ai sjell në transformimin dhe rregullimin e hapësirës gjeografike. Këtu ofrohet raporti i turizmit me mjedisin e tij gjeografik, popullsinë, ekonominë dhe efektet që sjellë zhvillimi i turizmit për vendet e caktuara. Gjithashtu, studentët do të mund të marrin njohuri mbi përhapjen gjeografike të turizmit në vendin tonë dhe më gjerë.
Qëllimet e lëndës:	Përmes kësaj lënde synohet të arrihen njohuritë e nevojshme sa i përket aspektit gjeografik të zhvillimit të turizmit, duke u përqendruar në ofertat turistike në zona të ndryshme gjeografike të cilat kanë kapacitete për zhvillimin e turizmit. Qëllimi kryesor është që studentëve t’iu ofrohet një bazë e kënaqshme e njohurive përmes të cilave ata do të mund të njohin më mirë aspektin gjeografik të turizmit, përkatësisht ofertën turistike, lokalitetet, kapacitetet, zonat e shumëçka tjetër që ndërlidhet me këto pjesë. Po ashtu, synohet që studentët të përfitojnë dituri mbi potencialet natyrore dhe shoqërore të ofertës turistike, organizimit, përdorimit, strategjisë, infrastrukturës, ruajtjes dhe ripërtëritjes të ofertës turistike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të kësaj lënde studentët duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të njohin konceptet e turizmit në përgjithësi, dhe të gjeografisë turistike në veçanti; ▪ Të kuptojnë funksionet dhe faktorët themelor për zhvillimin e turizmit; ▪ Të kuptojnë dhe të analizojnë ofertën primare dhe

	sekondare turistike; <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të identifikojnë dhe të dallojnë llojet e lëvizjes turistike sipas karakteristikave dhe motiveve të lëvizjes turistike dhe vendit; ▪ Të bëjnë klasifikimin e vendeve turistike sipas kriterëve përkatëse; ▪ Të njohin kapacitetet, lokalitetet dhe politikat turistike; ▪ Të identifikojnë tiparet e konkurrencës midis mbrojtjes së natyrës dhe turizmit; ▪ Të zbulojnë parimet kryesore ekoturistike dhe të analizojnë përparësitë, kufizimet dhe mbrojtjen ekoturistike; ▪ Të kuptoj ligjshmëritë e zhvillimit të turizmit në botë dhe në vendin tonë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	1
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	6	3	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj.			
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata dhe ushtrime të kombinuara me raste të studimit dhe diskutime në klasë, punime seminarike, diskutime, punë në grupe, etj.		
Metodat e vlerësimit:	Kolokviumi i parë: 0-30% Kolokviumi i dytë: 0-30% Ushtrimet, seminarët: 0-20% Hulumtimet shkencore: 0-10% Interaktiviteti: 0-10%		

	<p>Provimi përfundimtar: 100%</p> <p>Provimi final është vlerësuar me 100% të notës. Provimi përbëhet prej pyetjeve me përgjigje të mundshme, pyetjeve të hapura, dhe një rast të studimit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	Dhimitër Doka & Bilal Draçi, "Gjeografia e Turizmit", SHBLU, Tiranë, 2012.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Koja V., & Gorica, K., "Bazat e turizmit", Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë, 2004. ▪ Gashi, M., "Bazat e turizmit", ETMM, Prishtinë, 1986.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezentimi i syllabusit dhe hyrje e përgjithshme për lëndën
<i>Java e dytë:</i>	Koncepti turizëm dhe zhvillimi i tij
<i>Java e tretë:</i>	Historia e zhvillimi të turizmit dhe Turizmi në trajtimin shkencor
<i>Java e katërt:</i>	Elementet e gjeografisë në studimin e turizmit
<i>Java e pestë:</i>	Motivet, llojet dhe format e lëvizjes turistike
<i>Java e gjashtë:</i>	Aspektet metodologjike në studimin gjeografik të turizmit
<i>Java e shtatë:</i>	Kolokviumi I
<i>Java e tetë:</i>	Analiza gjeografike e hapësirës turistike
<i>Java e nëntë:</i>	Pasojat dhe efektet gjeografike të turizmit
<i>Java e dhjetë:</i>	Turizmi dhe mjedisi
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Problemet e biodiversitetit dhe turizmi
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Ekoturizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Aspektet gjeografike të turizmit në botë
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Turizmi në Kosovë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kolokviumi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>